



ДРЖАВЕН ЗАВОД ЗА РЕВИЗИЈА
ENTI SHPETËROR I REVIZIONIT
STATE AUDIT OFFICE

Abstrakti i raportit përfundimtar i revizionit

Subjektet kyçe të përfshira me raportin e revizionit:
Ministria e Drejtësisë

Lënda e revizionit:

Revizioni i raporteve financiare dhe revizioni i pajtueshmërisë së llogarisë së buxhetit themelor (637) për vitin 2020

Qëllimi i revizionit:

Të fitohet bindje e arsyeshme nëse raportet financiare të marra janë liruar nga paraqitjet e gabuara materialisht dhe transaksionet dhe aktivitetet e reflektuara janë në pajtim me rregullativën ligjore.

Gjendjet kyçe të konstatuara:

- nuk është arritur funksioni i njësisë së revizionit të brendshëm në Ministri;
- nuk është kryer regjistrimi i plotë i mobilieve të zyrës të prokuruar për nevojat e Gjykatës Themelore Penale;
- janë paguar mjetet për të cilat nuk është vepruar plotësisht sipas marrëveshjes dhe
- nuk janë ndërmarrë veprime për sigurimin e dokumentacionit për të drejtën e përdorimit të mjeteve të paluajtshme, për disa nga departament rajonale të ministrisë.

Rekomandimet kyçe:

- të vazhdohet me ndërmarrjen e masave për ekipimin dhe funksionimin e revizionit të brendshëm;
- të kryet dhe regjistrimi i mobilieve të zyrës të prokuruar për Gjykatën Themelore Penale, harmonizimi i gjendjes faktike me gjendjen e kontabilitetit dhe lidhja e marrëveshjes për dorëzimin e mobilieve dhe
- sigurimin e dokumenteve dhe rregullimin e të drejtës së përdoruesit të objekteve ku ndodhen departamentet raionale.

Vërejtjet e marra të draft-raportit:

Janë marrë vërejtje për draft-raportin e revizorit të autorizuar shtetëror nga ana e ministrit të drejtësisë

Mendimi i dhënë/përfundimi *:



Shprehëm mendim me rezervë për vërtetësinë dhe objektivitetin e raporteve financiare dhe mendim pa rezervë për pajtueshmërinë e transaksioneve financiare me rregullativën ligjore relevante, udhëzimeve dhe politikave të vendosura.

Dobësitë kyçe të sistemit:

- në dispozitat e marrëveshjes vjetore për rregullimin e të drejtës dhe detyrimet e ndërsjella ndërmjet Ministrisë dhe SHPPP-së nuk janë përfshirë shërbimet për ndërmjetësim dhe
- Ligji për financimin e partive politike nuk e përcakton afatin kohor në cilin Ministri duhet t'i marrë të dhënat nga institucionet kompetente, për miratimin e Aktvendimit dhe pagesën e mjeteve.

Përgjigjet e vërejtjeve të marra:

Nga shtatë vërejtje, dy janë pranuar, një vërejtje është pranuar pjesërisht, një vërejtje ka qenë sqarim i situatës, një njoftim për masat e ndërmarra, ndërsa të tjerat paraqesin koment të gjendjes së konstatuar dhe nuk janë pranuar.

* pozitive, me rezervë të pavolitshëm të përmbajtur